

Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Middle East Technical University (METU), në Ankara, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Middle East Technical University, në Ankara, Turqi, në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e UT-së për studime, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime me bursë Erasmus+;
- Shkëmbimin e studentëve për studime me o grant (studenti nuk paguan tarifë shkollimi në Universitetin METU, por shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe qëndrimit i mbulon me vetë)

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (shkëmbim për studime);
- Master (shkëmbim për studime);

*Studentët e nivelit Bachelor, duhet të kenë përfunduar minimalisht një vit studime në UT;

*Studentët e nivelit Master mund të kryejnë edhe kërkimin e tezës së diplomës, por duhet të kontaktojnë në mënyrë individuale me një profesor nga Universiteti METU, sipas programit të studimit, i cili është i gatshëm të punojë me ta.

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i METU klikoni në adresat:

<https://catalog.metu.edu.tr/>

https://oibs2.metu.edu.tr/View_Program_Course_Details_64/main.php

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët që përfitojnë bursë Erasmus+);
- Kostot e udhëtimit (275 EUR, për studentët që përfitojnë bursë Erasmus+);

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze / turke);
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit i nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe i përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B1 sipas sistemit CEFR (anglisht / turqisht, në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement (studenti duhet të kryejë në METU minimalisht 30 ECTS);

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin METU lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studentit kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze / turke);
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit të nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe i përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / turke, në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze / turke);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B1 sipas sistemit CEFR (anglisht / turqisht, në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement (studenti duhet të kryejë në METU minimalisht 30 ECTS);

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin METU lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studenti kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Afati për aplikim: **04 Shkurt 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!